



**Procesverbali i mbajtjes së konsultimit publik me qytetarë për Projekt-Planin e punës së Kuvendit Komunal të Prizrenit për vitin 2023**

Konsultimi publik me qytetarë është organizuar nga grupi punues për hartimin e Projekt-Planin e punës së Kuvendit Komunal të Prizrenit për vitin 2023, komisioni ka këtë përbërje: Antigona Bytyqi, Kryesuese e Kuvendit; Ilir Gashi, anëtarë nga LVV; Egzona Hoxhaj, anëtare nga PDK; Marin Përgjoka, anëtar nga LDK; Agnesa Sinanaj, anëtare nga AAK; Shukri Quni, anëtar nga NISMA; Do të sillet me shkrim një anëtare nga KDTP; Merdžan Osmani, anëtar nga NDS; Sead Arifi, anëtar nga VAKAT; Admir Aljilji, anëtar nga SDU dhe Ertan Simitçi, anëtar nga YTHP.

Njoftimet për qytetarë për organizimin e konsultimit publik janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Publikimet janë bërë në webfaqe, në facebook dhe në platformën e konsultimeve publike:

**Në webfaqe me: 22.11.2022:**

<https://kk.rks-gov.net/prizren/konsultime-publike/planet-ne-konsultim-publik/>

**Në facebook me: 11.11.2022:**

[https://m.facebook.com/story.php?story\\_fbid=451417677017892&id=100064489910139](https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=451417677017892&id=100064489910139)

**Në platformë me 11.11.2022:**

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41549>

**Konsultimi është mbajtur në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal (Shtëpia e Bardh).**

**Pjesëmarrës nga zyrtarët komunal:**

-Antigona Bytyqi, Kryesuese e grupit punues-kryesuese e kuvendit.

-Haziz Krasniqi, përgjegjës për konsultime publik.

Gjithashtu pjesëmarrës në konsultim publik edhe grupet e tjera të interes përkatësisht mediet.

### **Konsultimi ka nisur në orën 10:15.**

**-Antigona Bytyqi**, kryesuese e grupit punues njëherit edhe kryesuese e kuvendit, ka bërë hapjen e konsultimit publik:

Qytetarë të nderuar, të nderuara media, kam nderin që si kryesuese e kuvendit dhe në emër të grupit punues për hartimin e Projekt-Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023, t'ju përshëndes për praninë e juaj sot në këtë konsultim publik.

Konsultimi publik është organizuar në bazë të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutit të Komunës Nr.01/011-5643 dhe nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06.2018 për Standardet Minimale të Konsultimeve Publike në Komuna, sipas këtij udhëzimi njoftimet janë bërë me kohë dhe janë publikuar në webfaqe të komunës, Platformën e Konsultimeve Publike dhe në Facebook. Siç e dini është procedurë e paraparë ligjore që me e përgatit planin e punës së kuvendit. Në mbledhjen e 17 tetorit, është miratuar propozim-vendimi për formimin e punues për hartimin e Projekt-Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023.

Me datë 03 Nëntor 2022, Grupi punues, shefat e grupeve parlamentare, ekzekutivi në bashkëpunim me OSBE-në kemi mbajtur edhe një punëtori për hartimin e planit. Ky dokument është në konsultim publik nga data 11.11.2022 dhe në konsultim do të jetë deri me 11.12.2022, komentet dhe sugjerimet mund të dërgohen deri me 09.12.2022.

Ju njoftoj gjithashtu se prezent janë edhe përkthyesit e komunës.

**-Haziz Krasniqi**, përgjegjës për konsultime publik ka thënë: Kryesuesja e tregoj bazën ligjore se ku është bazuar përgatitja e këtij plani, njoftimet dhe dokumentet tjera përcjellëse. Procesverbal do të mbahet për këtë konsultim publik, sigurisht që do të përgatitet edhe raport, raportet janë duke u bërë për herë të parë në këtë format dhe të njëjtit publikohen në webfaqe të komunës dhe në platformën e konsultimeve publike. Në raport janë të përfshira të gjitha procedurat e ndjekura, duke filluar nga vendimi si dhe mbajtja e punëtorisë . Komentet që i pranojmë çoftë në formë fizike apo edhe në formë elektronike, jemi të obliguar që sipas udhëzimit administrativ të kthejmë

përgjigje për secilin koment. Sigurisht që ne jemi të hapur që edhe sot t'ju kthejmë përgjigje kushdo që ka pyetje, koment apo edhe sugjerim.

**-Bashkim Gashi**, qytetarë ka thënë: Nuk pata kohë me e shikuar planin për secilën pikë, por që për këtë plan i kam disa propozime në rast që janë të përfshira atëherë konsideroni si mbështetje për atë që keni punuar, në rast se nuk janë, nëse e shihni të arsyeshme t'i shqyrtoni propozimet dhe të gjejnë vend në planin final.

**Propozimi 1:** Përgatitja për zgjedhjen e kryetarëve të lagjeve dhe bashkësive lokale (lagjeve), pasi që të gjithë kryetarëve u ka skaduar mandati dhe se e kemi një udhëzim administrativ i cili obligon zgjedhjen e tyre, kjo duhet të bëhet sa më parë që është e mundur. Zgjedhja e tyre duhet të bëhet në fillim të vitit të ri (2023) në mbledhjen e parë të kuvendit. Në mënyrë që të arrihet koha e duhur apo para pushimeve të verës të kryhet ky proces, pasi që e dimë gjatë pushimeve të verës është shumë vështirë që qytetarët me i grubullu në takime. Miratimi i rregullores duhet hap rrugë që në kuvend të zgjidhet komisioni, pasi që kuvendi e zgjedh edhe komisionin i cili e bënë mbikëqyrjen e atij procesi. Gjithashtu në fund mbetet edhe një pikë

**Propozimi 2:** Raportimi në kuvend i komisionit për zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave dhe lagjeve.

**Propozim 3:** Raportimi i të gjithë komisioneve që i zgjedh kuvendi (pasi që në të kaluarën nuk ka qenë praktikë), komisionet e mëparshme nuk kanë raportuar komisionet duhet raportojnë për të ditur qytetarët se çka ka punuar ai komision. Një raportimi i tillë rrit transparencën tek qytetarët.

**Propozim 4:** Kuvendi ka vendos që gjuha rome të jetë gjuhë në përdorim zyrtar, e dimë që është rregullorja për përdorimin e gjuhëve në komunën e Prizrenit. Sigurisht që tani ligji na obligon që në këtë rregullore të futet dispozitat e atij vendimi që thotë që edhe gjuha rome është në përdorim zyrtar në komunën e Prizrenit. Për këtë është votuar në kuvendin komunal të Prizrenit nga anëtarët e kuvendit. Për këtë rregullorja në fjalë të shkoj në procedura për ndryshim ashtu siç e kërkon ligji kjo propozoj që të bëhet në fillim të vitit (2023). Pasi që në udhëzim administrativ thuhet që 90 ditë pas e miraton kuvendi duhet të bëhen plotësimet e akteve tjera normative.

**Propozim 5:** Përgatitja e rregullores për parkingje, duke e ditur që në Prizren është përgatitja e një rregulloreje të tillë është e rëndësishme, kjo të përgatitet në periudhën e parë të vitit 2023.

**Propozim 6:** Raportimi në kuvend për zbatimin e Planit Komunal të Veprimit, të caktohet data që së paku 1 apo edhe 2 herë në vit të jetë pikë e rendit të ditës ky raportim sepse nëse nuk raportohet nuk kemi bërë asgjë, sigurisht që plani edhe mund të ndryshohet sipas kërkesave ligjore të veçanta.

**-Haziz Krasniqi**, përgjegjës për konsultime publik ka thënë: Tek pjesa e rregullores që e cekët për zgjedhjen kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve qenke mirë i informuar që është një udhëzim administrativ dhe pikërisht ai udhëzim e ka bërë problemin që nuk po mund ti zgjedhim kryetarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve, jo pse ne nuk po dojmë me i zgjedh. Secilin dokument që e përgatit komuna, kryetari i komunës nxjerr vendim për formimin e grupit punues për hartimin e dokumentit, për hartimin e rregullores në fjalë kryetari komunës e ka nënshkruar vendimin për formimin e komisionit për hartimin e asaj rregulloreje grupi punues i ka mbajtur disa takime dhe po besoj që në 6 mujorin e parë të vitit 2023 rregullorja do të kryhet.

Siç edhe e dini deri tek miratimi në kuvend i një rregulloreje merre kohë së paku 2 muaj deri në dërgim për miratim të dokumentit në kuvend. Por duhet të presim se mos po ndryshon udhëzimi, si do që të jetë ne do të kryejmë rregulloren.

Kurse rregulloren për parkingje sigurisht që ne do të vendosim si pikë në plan, ndërsa tek raportimi së paku 1 herë në vit për zbatimin e Planin Komunal të Transparencës, po besoj që nuk na paraqet problem, edhe pse realisht plani është katër vjeçar, na është kërkuar që të bëhet katër vjeçar sepse në të kaluarën ka qenë një vjeçar. Raportimi mund të bëhet në janar ose në shkurt (2023)

**-Antigona Bytyqi**, ne e kemi paraparë edhe në plan e vitit 2022, gjithashtu e kemi paraparë edhe me planin e vitit 2023 që të gjitha komitetet dhe komisionet që janë themeluar, do të raportojnë këtu, kështu që edhe në dhjetorin e këtij viti dhe në dhjetor të vitit tjetër do të raportohet nga të gjitha komisionet.

Projekt planin mund ta gjeni të publikuar në webfaqe: <https://kk.rks-gov.net/prizren/konsultime-publike/planet-ne-konsultim-publik/> si dhe në Platformën e Konsultimeve Publike: <http://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41620> .

**Konsultimi publik është mbyllur në orën 10:30.**

Nga zyrtarët përgjegjës, projekt plani në formë fizike u është shpërnda qytetarëve pjesëmarrës në konsultim publik.

Me 23.11.2022, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

[https://m.facebook.com/story.php?story\\_fbid=502166498609676&id=100064489910139&mibextid=Nif5oz](https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=502166498609676&id=100064489910139&mibextid=Nif5oz)

Video incizimi për mbajtjen e konsultimit publik:

<https://www.facebook.com/TVBESA/videos/3378769809067925>

**P.S**

Dokumentet në webfaqe janë publikuar me vonesë pasi që webfaqja ka qenë jofunksionale, dhe nuk është lejuar të publikohen asnjë dokument. Publikimet janë bërë pasi që webfaqja është funksionalizuar.

Kryesuese e grupit punues:

Antigona Bytyqi

Procesmbajtës:

Haziz Krasniqi